



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02Nr. 334105-46339 dt. 13/09 2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **24.08.2023**, ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale. Mungoj Hamit Kastrati.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend Dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i dt. 27.07.2023.
2. Propozim Vendim për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023.
3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024.
4. Raporti i punës Janar-Qershor 2023, i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.
5. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "Klubi i Hendbollit Drenica"
6. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "FC Liqeni"
7. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit "Klubi i Boksit Drenasi"
8. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "Klubi i Futbollit" Feronikeli "Femra.
9. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, KV "Feronikeli" Meshkuj.
10. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, SHKA "Shotë Galica"
11. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, KV "Feronikeli Femrat"
12. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "SHKA SHQIPET E DRENICES"
13. Propozim Vendim për financimin e Projektit nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për projektin e Lulzim Nika, për projektin Botimi i Librit "Kosova në dokumentet e qeverisë Amerikane 1945-99" gjatë vitit 2023.
14. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "Fc Feronikeli 74".

15. Propozim Vendim për financimin e Projektit OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "KV Gryka".
16. Raport i takimit të komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuara për dhënie të pronave me negociim .
17. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr 06-070/01-39017, dt 09.08.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer, Adenocarcinoma ductalis pancreatis, në shumën totale prej 1,600.00 euro.
18. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr 06-070/01-41320, dt 21.08.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer, Adem. Carcinom, dhe sëmundjes Arrest Kardio respirator, në shumën totale prej 1,600.00 euro.
19. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, sqaroi se nuk e kemi respektuar afatin e thirrjes se mbledhjes për arsyeje se ministria e ka dërguar një shkresë Propozim Vendim për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023, afati fundit deri me 15 shtator prandaj kemi thirr mbledhje të rregullt, kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, theksoi se kemi edhe një pikë shtesë për rend dite: Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr 01-070/01-0041969/23, dt 23.8.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer ovarian në shumën totale prej 1,600.00 euro.

Hamit Haxhiu, këto propozim vendime që janë për financim të projekteve nuk kanë kurrfarë ndryshimi prej mbledhjes se kaluar, ne kërkuam specifikat raportet e komisionit të qdo klubi dhe sqarimi që është këtu është i njëjti për të gjithë nuk ka kurrfarë ndryshimi.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, asnjë gjë nuk ka ndryshu sepse janë propozim vendime, problemin e ka ngrit Arbëri ka ndalesa apo nuk ka ndalesa dhe a ekziston klubi apo jo, ne ju japim sqarime, dokumentet i ka shqyrtua një komision profesional komunal i komunës dhe çka ju intereson me pas keni të drejt me pas qasje ne dokumente publike dhe kërkon i shikoni.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota "**Për**", kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës, bashkë me një pikë shtesë që u cek me lartë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 13.04.2023.**

Florentina Elezi-Veliu, këtë here keni shkru me shumë se sa që duhet në procesverbal, kërkoj shkru ma qartë dhe ma shkurt, ato çka janë tepër mos i cekni.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, pra zyra Kuvendit nuk bën trasnkript bën vetëm procesverbal, për çështjet që merren për vendimet çka merren vetëm diskutimet thelbësore.

Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota "**Për**", kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023.**

Shyqiri Bublaku-Drejtor i Financave, sipas ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për tatimin në pronë e paluajtshme neni 11/B Shuma e faljes se tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës se tatimit në pronë për vitin 2023, por jo me shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Ne e kemi hartu këtë propozim vendim dhe kemi kërkuar nga ju që të aprovohet edhe pse tatimi në pronë edhe një nder burimet kryesore të Komunës së Drenasit të të hyrave vetanake

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ju ftoj ta votoni, këtë propozim vendim, sepse jemi bazuar ne ligj dhe do ta zbatojmë.

Shyqiri Bublaku-Drejtor i Financave, çdo kush që e ka pagu tatimin në pronë për vitin 2023 ajo do t'i bartet në vitin 2024.

Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota **"Për"**, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e paluajtshme për vitin 2024.**

Shyqiri Bublaku-Drejtor i Financave, sa i përket normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024 parashihen, Baza tatimore per tatimpaguesit me prona te paluajtshme brenda një komuna përcaktohet si bazë e vetme tatimore sipas vlerës se kombinuar të të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit,

Vlera e detyrimit tatimor llogaritet sipas kufijve si në vijim:

Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore q mund të variojë prej 0.10% deri në 1%

Për vlerën e pronave mbi njëqind mije (100,000.00) aplikohet shkalla tatimore që mund te variojë prej 0.20 %deri 1%, plus tatimi si nenit që e ceka me lart.

Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore q mund të variojë perj 0.40% deri në 1% .

Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.40% deri1%

Për vlerën e pronave mbi pese milion (5,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.50 % deri 1%.

Vlerësimi i objekteve ka me u bërë këtë vit për vitin 2024.

Sa i përket shkalleve ne kemi shku ne shkallen me të ulet të cilën e parasheh ligji që me i kursy qytetaret tanë.

Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota **"Për"**, kundër nuk pati, abstenim nuk pati

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Raporti i punës Janar-Qershor 2023, i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.**
Nuk pati diskutime rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë deri tek pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim pikën nga pika e pestë deri tek pika e 15 të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 05 vota “Për”, kundër nuk pati, 1 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës: **16. Raport i takimit të komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negocim.**

Arben Shala-Nënkryetari i Komunës, Konkluzionet:

Komisioni nxori konkluzionet e mëposhtme:

1. TDI Balkans

- Sipërfaqja e përlogaritur për të tri parcelat është 56 ha.
- Është tokë e klasit të 6-të, për momentin e pashfrytëzuar.
- Kjo nuk angazhon numër të madh të punëtorëve por përfitimi nga qiraja është i kënaqshëm për komunën, mbi 750 euro për hektar.
- Në kërkesë kërkohet parcela P – 70314035-01317-0, përderisa në listën e lokacioneve të mundshme për investim në Komunën e Drenasit, kjo parcelë figuron me numrin P – 70314035-01317-1. Kërkohet që të kihet vëmendje për këtë çështje dhe të përmirësohet. Në mënyrë unanime komisioni rekomandoi që kërkesa e lartpërmendur nga TDI të merret në konsideratë pozitivisht, respektivisht të aprovohet kërkesa e tyre duke marrë parasysh çështjet e lartpërmendura.

2. Frida's Farm

- Sipërfaqja fillestare e kërkuar është 20ha me mundësi zgjerimi edhe për 40-50 të tjera.
- Me këtë përfitimi i komunës është në numrin e të punësuarve, përderisa sa i përket pagesës për shfrytëzim të pronës, komisioni aprovoi opsionin e dytë për qira vjetore prej 319 euro në vit.
- Komisioni tërheq vëmendjen se pas 20 ha të parë mund të ketë vështirësi në sigurimin e hektarëve tjerë pasi që nëse në ndërkohë vjen një ofertë e kënaqshme, mund të jepen në shfrytëzim e jo të pritet pas vitit të 5 që Frida's Farm e kërkon. Në mënyrë unanime komisioni rekomandoi që kërkesa e lartpërmendur nga Frida's Farm të merret në konsideratë pozitivisht, respektivisht të aprovohet kërkesa e tyre duke marrë parasysh çështjet e lartpërmendura.

Florentina Elezi-Veliu, fatkeqësisht nuk kam pas mundësi me qenë në mbledhje të komisionit, për ofertën e parë kam qenë prezent dhe çka nuk më ka pëlqy që ne nuk e kemi ngrit token tonë mirëpo e kemi kesh, para investitorëve nuk guxon me e bërë këtë gabim, ju rekomandoj që mos të ndodh herëve të tjera kjo. Meqë është me panele solare rekomandoj që rrymën e komunës a ndonjë shkolle a diçka, edhe qiraja shumë e ulët.

Arbër Halilaj, duke u bazuar në ligjin për dhënien e pronës në shfrytëzim unë e vlerësoj shumë që është bërë negocimi, ose propozimet janë trajtuar në këtë formë më komision, e kam shikuar projektin dhe jam për të dyja projektet me ia mundësi token siç e kanë kërkuar me ato kushte.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës: **17. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr 06-**

070/01-39017, dt 09.08.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer, Adenocarcinoma ductalis pancreatis, në shumën totale prej 1,600.00 euro. Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota "Për", kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetëmbëdhjetë të rendit të ditës: **18. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr 06-070/01-41320, dt 21.08.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer, Adem. Carcinom, dhe sëmundjes Arrest Kardio respirator, në shumën totale prej 1,600.00 euro.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota "Për", kundër nuk pati, abstenim nuk pati

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nëntëmbëdhjetë të rendit të ditës: **19. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, nr 01-070/01-0041969/23, dt 23.8.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes kancer ovarian në shumën totale prej 1,600.00 euro.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota "Për", kundër nuk pati, abstenim nuk pati

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëzet të rendit të ditës: **20. Të ndryshme**

Arbër Halilaj, kërkoj që seancat të udhëhiqen me mirë me gjithë respektin sepse seancën e kaluar ka qenë ka qenë një sjellje arrogante nga ana e kryetarit dhe nuk ka nevojë me mu ndal fjala deri sa e bën asamblisti një kërkesë pa arsyetim si ka kuptim, ta bëjmë kërkesën pa arsyetim.

Hamit Haxhiu, pasi që jemi tek sporti tek organizatat jo qeveritare, ne qofte se subvencionimi i klubeve është një buxhet deri në sa përqind ka të drejt me e qu atë buxhet në një klub a guxon me kalu 50% e atij subvencionimi?

Petrit Gashi- Drejtor për Urbanizëm dhe Mbrojtje te Mjedisit, është komisioni që vendos për këto por zakonisht varet prej rëndësisë se klubit dhe nivelit të garës që garon.

Arbër Halilaj, sa i përket financimeve, vet fjala projekt tregon që ekziston një projekt me specifikacione, dhe ajo çka kam diskutua në seance u kanë në favor të asamblesë të kryetarit dhe unë vetëm po kërkoj transparence dhe llogaridhënie, ne vetëm votojmë subvencionime dhe asnjëherë askush nuk raporton, klubi ka pas shumë telashe dhe askush nuk vjen me raportu, kërkesa jonë qw me u rrit transparencia dhe llogaridhënia.

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 11:03 min .

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari